



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS**

**MIRATOHET
MINISTRI**

Luan MEMUSHI

PROGRAMI I LËNDËS

SË EDUKIMIT FIGURATIV

KLASA III

CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE

Tiranë, 2005

I. HYRJE

II. SYNIMI

III. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

IV. STRUKTURA E PROGRAMIT

V. PROGRAMI SINTETIK

VI. PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

VII. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

VIII. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE

IX. LIDHJA ME JETËN DHE MJEDISIN

X. MJETET DHE PËRDORIMI I TYRE

I. HYRJE

Programit i edukimit figurativ për klasën e tretë është vazhdim i programeve të reja të hartuar përklasat I e II të sistemit të shkollës 9-vjeçare. Programi realizon atë që duhet të njohin dhe të bëjnë nxënësit në edukimin figurativ, duke u mbështetur fort në psikologjinë e moshës. Ai ka në qendër përvojën e nxënësit, të cilën kërkon ta njohë, ta zhvillojë, ta pasurojë e ta çojë më përpara, duke e ndërthurur atë në mënyrë të natyrshme me historinë, kulturën e artin jo vetëm të mjedisit ku jeton e mëson fëmija, por edhe me atë të krahinave të tjera e të vendeve të ndryshme të botës, që ai ta ndiejë veten pjesë të së tërës, të botës ku jetojmë. Edukimi figurativ nëpërmjet këtij programi i krijon mundësi nxënësit të fitojë njohuri, aftësi, shkathtësi, shprehi, të mbajë qëndrime e të krijojë vlera, të cilat i interpreton në mënyrë origjinale. Ky program do ta ndihmojë nxënësin të zgjidh problemet e tij estetike për të qenë sa më i suksesshëm në jetë.

II. SYNIMI

Programi i edukimit figurativ në klasën e tretë ka për qëllim të ndihmojë në formimin artistik të nxënësit për kuptuar artin figurativ dhe për t'u shprehur nëpërmjet tij.

Ky program synon të realizojë formimin artistik të nxënësit duke i pajisur ata me:

Njohuri:

a) për bazën materiale që e ka përdorur edhe në klasat e mëparshme, por kryesisht do të përqendrohet në përdorimin e penelit, të plastelinës dhe përdorimin e tekstileve e fijeve më të holla; teknikat për të realizuar një vepër arti, si: kolazhe, akuarel, tempera, tekstil (qëndisje sipas vijës së lakuar me basme), stampim (stampat me ngjyra), stampime me stampa të përgatitura nga vetë nxënësit, dizajnit (gdhëndje, gërryerje);

b) për elementet e parimet e artit duke përfshirë njohuri për ngjyrat e para e të dyta, *zgjerimin* e njohurive për llojet e vijave, perspektiva lineare për objektet afër-larg, simetria boshtore, format me 2-3 përmasa, barazpeshën, theksin, lëvizjen, unitetin, kontrastin; c) përdorimin e simboleve e të tematikave të larmishme nga jeta e tyre e mjedisi; d) për historinë e kulturën e artit pamor të vendit e botëror; e) për analizën, vlerësimin, interpretimin e një punimi artistik të vetin, të shokut apo të një vepre të caktuar arti, si dhe zhvillimin e një fjalori të caktuar artistik (ritmi, barazpesha, kontrasti, lëvizja, variacioni, qendra e interesit, përsëritja); f) për rolin e artit dhe të artistit në komunitet e në jetën e përditëshme.

Aftësi:

a) Për të vëzhguar e për të dalluar ngjyrat e para e të dyta, për përdorimin e akuarelit, pastelit, temperas, marrëdhëniet në mes rrethit të ngjyrave, përcaktimin e ngjyrave të ftohta e të ngrohta; përcaktimin e sipërfaqeve për të krijuar me teknikën e kolazhit b) për identifikimin e ideve, të simboleve dhe të gjuhës emocionale në një krijim artistik; c) për përshkrimin dhe interpretimin e karakteristikave të një vepre arti dhe karakterin historik të tyre; për të sjellë përvojën e tyre në klasë nga përvoja jetësore; si dhe aftësi praktike për të krijuar një ilustrim, një afresk; d) për të analizuar dhe për të zbatuar dhe për të vlerësuar në bazë të njohurive të marra punën e tyre e të shokut apo një vepre arti; e)

për bashkëpunim, për të punuar në grup, për të dëgjuar mendimin e shokut, për të krijuar miqësira e për të pakësuar mosmarrveshjet; f) për ta gjetur të bukurën në orenditë shtëpiake, rregullimin e mobiljeve në arkitekturën e ndërtesave, në arkitekturën e mjedisit; për të përdorur imagjinatën, fantazinë, ëndrrat në veprimtarinë krijuese.

Shkathësi:

a) për përdorimin e bazës materiale, si: lapsi, goma, peneli, bojërat, pastela, plastelina etj; b) për përdorimin e fjalorit artistik në përcaktimin e elementeve të artit, karakteristikave të tyre, përshkrimin e veprave artistike; c) për komunikimin nëpërmjet simboleve.

Qëndrime:

a) për të qenë të pavarur në vlerësime e në dhënien e mendimeve; b) për të respektuar mendimin e tjetrit për atë që kanë e duan të transmetojnë me punën e tyre; për të marrë përgjegjësi për punën që bëjnë, për përgjigjet që japin, për lidhjet që krijojnë.

Vlera:

a) respektimi i lirive e të drejtave të njeriut në këtë fushë, si: përzgjedhja e materialeve, elementeve, parimeve për të shprehur idetë, mendimet e ndjenjat e tyre; respektimi i traditave e zakoneve; realizimi i detyrave e përgjegjësi për të përfunduar një detyrë, për mirëmbajtjen e mjeteve, krijimin e dosjes.

III. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në fund të klasës së tretë nxënësi të jetë i aftë:

- Të krijojë punë të ndryshme arti, me 2–3 përmasa, që komunikojnë ide, mendime, ndjenja, përvoja, për një qëllim të caktuar;
- Të përdorë elementet dhe parimet e artit (ngjyrat, vijat, formën, hapësirën, sipërfaqet, baraspeshën, kontrastin, raportin, theksimin) në mënyrë të përshtatshme për këtë nivel;
- Të përshkruajë sesi elemente të ndryshme të artit (të ndeshura në vepra arti) lidhen me njohuritë dhe përvojat e tyre;
- Të përdorë një fjalor dhe terminologji artistike, të thjeshtë për këtë nivel.

IV. STRUKTURA E PROGRAMIT

Struktura e programit të edukimit figurativ është ndërtuar mbi 6 linja, të cilat krijojnë një mundësi për të arritur objektivat kryesorë të të mësuarit:

- Baza materiale, procese, teknika,
- Parime dhe elemente,
- Tematika,
- Histori dhe kulturë,
- Analiza, interpretimi dhe vlerësimi,
- Lidhjet ndërlëndore me jetën dhe mjedisin.

V. PROGRAMI SINTETIK

35 javë x 1 orë = 35 orë

- Baza materiale, procese e teknika	2 orë
- Elemente dhe parime	17 orë
- Tematika	3 orë
- Histori dhe kulturë	4 orë
- Analiza, interpretimi, vlerësimi	3 orë
- Lidhjet ndërlëndore dhe me mjedisin	3 orë
- Orë në dispozicion	3 orë

VI. PROGRAMI ANALITIK SIPAS ÇDO LINJE

Linja I. Baza materiale, procese, teknika (2 orë)

Nxënësi të njohë, të përzgjedhë dhe të përdorë materiale, mjete, procese e teknika, duke komunikuar ndjenja dhe emocione . Ai të:

- përdorë *materiale* të ndryshme dhe të njohë efektet që ato krijojnë: lapsa, pastela, shkumësa, akuarele, letër me ngjyra, letër vizatimi, kartona, letër e zakonshme, bojëra uji, tempera, furçën, plastelinën, materiale për gdhendje;
- njohë dhe të përdorë *teknikat, si:* akuareli, tempera, stampimi, vizatimi, modelimi i baltës, gdhendia (në sapun), kolazhi, tekstili etj.

Krijim- gdhendje në sapun; qëndisje.

Linja II. Elemente dhe parime 17 orë

Nxënësi të njohë e të përdorë elementet e parimet e artit në punimin e tij. Ai të njohë:

Vijat

- Të krijojë iluzionin e formës ose të volumit nëpërmjet vijave.

Përdorimi imagjinatës për të krijuar peisazhin e qytetit, duke përdorur llojet e vijave: *e përkulur, e trashë, e hollë.* (1 orë)

Format 2-përmasore

- Të përdorë në krijimet e tij më shumë se një lloj forme për të ndërtuar një objekt.
- Krijimi i një maske. (2 orë)

Format 3 përmasore:

- Të krijojë iluzionin e formës 3-përmasore (volumin) mbi një sipërfaqe 2-përmasore (fleta e vizatimit).

Vizatimi me dritë hije i një objekti të thjeshtë. (2 orë)

Sipërfaqja

- Të krijojë sipërfaqen nëpërmjet vijave të përsëritura, formave dhe hapësirave.

Krijim përmes thurjes me lecka ose me fije etj. (1 orë)

Ngjyra

- Të njohë dhe të krijojë nuancat e ngjyrave: të ngrohta e të ftohta, duke i përzier me të bardhën e të zezën.

Përdorimi i ngjyrave plotësuese: kuqe-jeshile, blu –portokalli, lejla - verdhë në një krijim. (1 orë)

Hapësira

- Të japë iluzionin e hapësirës në krijimet e tij, nëpërmjet mbivendosjes së figurave.

- Përdorimi i konceptit të planeve, plani I,II,III.

Krijim- Pejzazh ose natyrë e qetë. (1 orë)

Barazpeshë

- Të përdorë ngjyrat, vijat, format për të krijuar barazpeshën në krijimet e tij.

Krijim i një maske (1 orë)

Theksi:

- Të përdorë ngjyrën për të tërhequr vëmendjen e shikuesit dhe për të theksuar objektin kryesor.

Krijim: Kompozimi me kafshë (2 ose më shumë, duke përdorur ngjyrën për të theksuar njërin prej tyre), kolazh.

(2 orë)

Lëvizja:

- Të krijojë lëvizjen nëpërmjet mbivendosjes së figurave dhe formave.

Krijim : Gara e vrapimit

(2 orë)

Uniteti:

- Të krijojë unitetin nëpërmjet përdorimit të vlerave dhe intensitetit të ngjyrës.

Krijim: Kompozimi “Lëndina me lule” (1 orë)

Kontrasti:

- Të krijojë thellësinë në punimet 2-përmasore nëpërmjet kontrastit.

Krijim: Kompozim ku nëpërmjet përmasave dhe ngjyrave të ndryshme të krijojë thellësinë. (1 orë)

Harmonia:

- Të krijojë harmoninë në një krijim duke përdorur ritmin (përsëritja e një elementi për të krijuar të tërën (ritmi);

Krijim : Dekoracion me motiv të thjeshtë.

(1 orë)

Linja III. Tematika

3 orë

Nxënësi të shqyrtojë, të përzgjedhë dhe të përdorë shumëllojshmëri temash, simbolesh, idesh nga jeta e tij.

Ai duhet të:

- Përzgjedhë e të përdorë tema nga fusha të ndryshme, për të shprehur mendimet e veta ose për të përcjellë një mesazh.

Krijim: Temë e lire (teknika sipas dëshirës) (1 orë)

Krijim: Krijimi i një reviste ose gazetë sipas dëshirës (2 orë)

Linja IV. Histori dhe kulturë	4 orë
<i>Nxënësi të kuptojë edukimin figurativ në lidhje me historinë dhe kulturën.</i>	
Ait të njohë artistë të ndryshëm dhe veprat e tyre (vizitë në galerinë e qytetit ose bisedë e ilustruar në klasë);	(1 orë)
Krijim “Natyrë e qetë “ .	(2 orë)
Bisedë e lirë për të njohur artin popullor në objektet e përdorimit të përditshëm si (veshjet, qylymat, enët etj)..	(1 orë)
 Linja V. Analiza, interpretimi, vlerësimi	 3 orë
<i>Nxënësi të vëzhgojë, të përshkruajë, të analizojë, të interpretojë dhe të vlerësojë punimet e tij dhe të shokut që</i>	
- Të njohë teknikat e ndryshme të përdorura në vepra të ndryshme arti, si dhe mjetet dhe materialet. Bisedë e ilustruar në klasë (pikturë në vaj, skulpturë, etj.)	(1 orë)
- Të diskutojë për punën e tij dhe të shokut, mënyrën se i kanë përdorur njohuritë e marra në punën e tyre.	(1 orë)
Krijimi i një ekspozite vetjake ose e përbashkët në klasë ose diku tjetër	(1 orë)
Zgjerimi i fjalorit artistik në përshtatje me moshën.	
 Linja VI. Lidhja ndërëndore dhe me mjedisin	 3 orë
<i>Nxënësi të bëj lidhjet mes arteve figurativ dhe disiplinave të tjera në jetën e përditshme që:</i>	
- Të njohë rolin e artit në jetën e përditshme dhe në mjedisin ku jeton. Veprimtari praktike: Si të rregullojmë në mënyrë estetike mjedisin ku jetojmë	(1 orë)
- Të zbulojnë si njerëzit përdorin imagjinatën, ëndrrat dhe përvojat jetësore në krijimet e tyre artistike. Krijim: Një ëndërr, një ngjryje që u ka bërë përshtypje	(2 orë)

VII. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Zbatimi me sukses i programit kërkon përgatitje dhe përgjegjësi nga mësuesi, i cili të njohë, të drejttojë e të nxisë veprimtarinë e nxënësit. Mësuesit i duhet të njohë mirë përmbajtjen e programit, si dhe të jetë vazhdimisht i interesuar për të kualifikuar veten në mënyrë individuale apo të drejtuar nga institucionet përgjegjëse, të krijojë një bazë të fuqishme materiale për t’i paraprirë një zhvillimi normal të orës së mësimit, të sqarojë më parë të gjitha çështjet e paqarta të përmbajtjes që mos të jetë në dilemë për atë që do t’i transmetojë nxënësit. Tek zbërthimi i secilës linjë janë dhënë niveli i përvetësimit të koncepteve, teknikat, aftësitë, shprehjet, si dhe tema të mundshme për hartimin e planit tematik.

VIII. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE

Kriteret e vlerësimit janë përcaktuar në standardet e arritjes, një dokument të cilin mësuesi duhet ta ketë gjithmonë pranë për të qenë sa më i qartë e i saktë në vlerësim. Metodologjia për të vlerësuar nxënësin, nuk do të bazohet në konkurrencë, por në bazë të

një diskutimi të natyrshëm për arritjet dhe ato që nxënësi duhet të realizojë më mirë. Në diskutim marrin pjesë të gjithë nxënësit, të cilët orientohen nga mësuesi në bazë të objektivave të orës së mësimit. Ky diskutim zakonisht bëhet në fund të orës së mësimit. Në vlerësim të merret parasysh dhe vetëlerësimi i nxënësit, si dhe mendimi i shokut. Gjatë vlerësimit mësuesi të reagojë gjithmonë gjatë veprimtarisë së nxënësit. Vlerësimi me notë bëhet me grup-tema për të gjithë nxënësit apo dhe në mënyrë individuale sipas kriterëve që mund të vendosë shkolla.

IX. LIDHJA ME JETËN DHE MJEDISIN

Nëpërmjet kësaj lënde nxënësit do të evidentojnë lidhjet e kësaj fushe arti me llojet e tjera të artit, me lëndët e tjera mësimore dhe me mjedisin ku zhvillohet. Kjo lëndë tregon sesa i lidhur është arti figurativ me jetën tonë të përditshme, duke u siguruar mundësinë nxënësve që të krijojnë punë të ndryshme, duke ndërthurur artin figurativ me forma të tjera të artit. Kështu, për shembull, nxënësi mund të krijojë mbasi ka dëgjuar një pjesë muzikore, mund të lidhë një datë historike me një etapë të zhvillimit të edukimit figurativ etj.

X. MJETET DHE PËRDORIMI I TYRE

Përdorimi i mjeteve në punimin artistik është i domosdoshëm për të arritur një nivel të kënaqshëm gjatë veprimtarisë mësimore. Është shumë e rëndësishme që çdo nxënës të ketë kutinë e tij të mjeteve të punës, por në pamundësi shkolla mund të sugjerojë për të përdorur mjetet në grup.

Mjetet më të rëndësishme janë:

Grupi i pare: shkumsa me ngjyra (tetë ngjyra), lapsa me ngjyra, gomë dhe lapsi i zi HB, lapustila, akuarelet, pastela.

Grupi i dytë: vinovilë, letërngjitës, skoç, vizore, gërshtë.

Grupi i tretë: penelat të ndryshme, të cilat janë të përcaktuar në paketa të veçanta, penelet të jenë të disa madhësive, fletore vizatimi, fletore punëdore, letër tabak, kartona me ngjyra, letër për të shkruar A4.

Grupi i katërt: mbajtëse për dosjet e punës, mbajtëse për mjetet, enë për të mbajtur ujë për pastrimin e penelave, si dhe për krijimin e ngjyrave me tempera, akuarela.

Grupi i pestë: mjete për pastrimin, peshqirë të vegjël, kartëpeceta, gazeta.

Vendi i punës

Për të zhvilluar mësimin e edukimit figurativ, është shumë e rëndësishme që nxënësi të punojë me një dritë të plotë, me një vend të sigurt ku t'i mbështesë mjetet e tij, në një vend të ngrohët e pa lagështirë, të pastër. Vendi më i mirë për orën e edukimit figurativ është klasa-studio, por në pamundësi duhet që klasa të ketë kushtet e përshtatshme.

Shënim: Mbi këtë program mund të hartohen fletore pune për nxënësit, të cilat do të përzgjidhen më pas nga DAR.